

Besnik Çina

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar që nga muaji nëntor 2024. Nga qershori 2022 deri në nëntor 2024, ka ushtruar detyrën Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Nga Qershori 2021 deri në dhjetor 2021 ka ushtruar detyrën e administratorit në Universitetin e Mjekësisë Tiranë. Nga Shkurti 2014 deri në maj 2019 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Programimit, Buxhetit dhe Financës pranë Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në Ministrinë e Brendshme. Nga dhjetori 2007 deri në maj 2010 ka ushtruar detyrën e oficerit të kredisë pranë Fondit Besa sha. Nga janari 2001 deri në shkurt 2006 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Zyrës së Punësimit. Nga gushti 1997 deri në janar 2002 ka ushtruar detyrën e Kryetarit të Degës Ekonomike pranë Albtelekom sha.

Diplomuar në vitin 1994 në profilin “Ekonomist”, pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Diplomuar në vitin 2012, Master i Nivelit të Dytë (MSc), në profilin “Menaxhim Financiar” pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin Bujqësor të Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Hawai të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Diplomuar në vitin 2008 në profilin “Jurist”, në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe që nga viti 2016 mban titullin “Avokat” pranë Dhomës së Avokatisë, Tiranë.

Gjatë karrierës së tij z.Çina është trajnuar në fushën e financës dhe kontabilitetit si dhe në përgatitjen e PBA.

Njeh mirë gjuhën angleze.